



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



**KUVENDI KOMUNAL OBILIQ**

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr. 28, dt. 04.06.2008), bazuar në nenin 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës nr. I-34, dt. 25.04.2016, nenin 39 të Rregullores së Punës së Kuvendit nr. I-95, dt. 29.06.2018, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019, si dhe nenin 4 të Rregullores (KO) nr. 03/2022 për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Obiliqit, Kuvendi i Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës së DAP-së me nr. 03-104-02-7222-26, dt. 12.03.2026, në mbledhjen e mbajtur më dt. 31.03.2026, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet komisioni për përzgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Obiliqit, me këtë përbërje:
  - 1.1 Burim Ismaili – anëtar I Kuvendit nga LVV
  - 1.2 Mervete Shala – anëtare e Kuvendit nga LVV
  - 1.3 Linda Bektoshi – anëtare e Kuvendit nga LDK
  - 1.4 Fidan Ahmeti – anëtar i Kuvendit nga LDK
  - 1.5 Ariana Grajqevci – drejtore e Administratës (përfaqësuese nga ekzekutivi)
  - 1.6 Zelushe Kelmendi, përfaqësuese nga shoqëria civile
  - 1.7 **Përfaqësuesi nga Lokaliteti ku bëhet zgjedhja e Këshillit Lokal**
2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi i raporton Kuvendit të Komunës për procesin e përzgjedhjes së këshillave lokale.
3. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL-së, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

**Vendimi i dërgohet:**

- Kryetarit të Komunës
- Nënkryetarit të Komunës
- Anëtarëve të KK
- DAP
- MAPL
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

*Sami Ahmeti*  
Sami Ahmeti